

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Fllanza Kadiu, kryetare, Mejreme Memaj e Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Shaqë Curri, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të akuzuarës B.H., nga Peja, për shkak të veprës penale Vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 147 pika 3 e 9 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe të miturit A.Ll., nga Peja, për veprat penale Ndhimë në kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 147 pika 3 e 9 lidhur me nenin 25 të KPK dhe Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, parashikuar me nenin 291 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, atë të mbrojtësve të të akuzuarës avokatëve N.P. e RR.K. dhe atë të mbrojtësve të të miturit avokatëve F.Gj. e H.Ç., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.04/2013 datë 19 mars 2014, në seancën e mbajtur më 26 nëntor 2014, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësve të të akuzuarës B.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.04/2013 datë 19 mars 2014, vetëm sa i përket vendimit për dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarën për veprën penale të Vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 3 e 9 të KPK për të cilën është shpallur fajtores e gjykon me dënim burgu në kohëzgjatje prej 25( njëzet e pesë) viteve, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 8.05.2012 e tutje.

Ankesa e Prokurorit Themelor në Pejë dhe ajo e mbrojtësve të të miturit A.Ll. refuzohet si e pabazuar.

Aktgjykimi i lartcekur nën piken III të dispozitivit përkitazi me të miturin A.Ll. për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve-neni 328 par. 2 të KPK ngel i pashqyrtuar.

### A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin P.nr.04/2013 datë 19 mars 2014, të akuzuarën B.H. e ka shpall fajtores për veprën penale vrasje e rëndë, parashikuar me nenin 147 pika 3 e 9 të KPK, kurse të miturin A.Ll. për veprat penale ndihmë në kryerjen e

veprës penale vrasje e rendë, parashikuar me nenin 147 pika 3 e 9 lidhur me nenin 25 të KPK dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, parashikuar me nenin 291 par.1 të KPK, dhe i ka gjykuar: të pandehurën B.H. me dënim burgu në kohëzgjatje prej 29 (njëzetënjete) vite, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 8.05.2012 e tutje. Kurse, të miturin me dënim burgimi për të mitur në kohëzgjatje prej 8 (tetë) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 3.05.2012 deri me 6.05.2013. E akuzuara dhe i mituri janë obliguar secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 300€ si dhe në emër të paushallit gjyqësor nga 55 €. Të dëmtuarit F.Sh. e T.D. janë udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike. Me të njëjtin aktgjykim ndaj të miturit konform dispozitës së nenit 363 par.1 pika 3 lidhur me nenin 1 pika 1.2 të nënpika 1.2.5 të Ligjit mbi amnistinë nr.04/L-209 është refuzuar propozimi për shqiptimin e dënimit dhe është pushuar procedura penale për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, parashikuar me nenin 328 par.2 të KPK për shkak se vepra penale është përfshirë në amnisti. Ndaj tij është shqiptuar dënim plotësues – marrja e armës – revole e tipit zastava me nr. Serik ET-833809.

Kundër këtij aktgjykimi në afat kanë paraqitur ankesa:

-Prokurori Themelor në Pejë, vetëm sa i përket vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarës dhe të miturit tu shqiptohen dënime më të larta;

- mbrojtësit e të akuzuarës B.H. (ankesë të përbashkët) avokatët RR.K. dhe N.P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi sanksionin penal dhe shpenzimet e procedurës penale, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim;

-mbrojtësit e të miturit A.Ll., avokatët F.Gj. e H.Ç., gjithashtu kanë ushtruar ankesë të përbashkët, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet aktgjykimimi i kundërshtuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim apo të ndryshohet ashtu që i mituri të lirohet nga propozimi për shqiptimin e dënimit me burgim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me kohë i njoftoj palët për seancën e kolegjit, të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPP. Në seancë prezantoi Prokurori i Apelit, Sabri Ademi, e akuzuara B.H., të dy mbrojtësit e saj, dhe mbrojtësi i të miturit avokati Haxhi Qekaj, kurse i mituri dhe të dëmtuarit edhe pse të njoftuar me rregull nuk morën pjesë në seancë. Prokurori i Apelit, në deklarinimin në këtë seancë e mbështeti Parashtresën me shkrim PPA/1.nr.461/2014 datë 23.09.2014, me të cilën ka propozuar që ankesa e Prokurorit Themelor të aprovohet, ashtu që të akuzuarës dhe të miturit tu shqiptohet një dënim me i rendë me burgim, kurse ankesat e mbrojtësve të të akuzuarës dhe mbrojtësve të të miturit të refuzohen si të pabazuara

Kolegji i kësaj Gjykatë në seancën e kolegjit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, studimit të aktgjykimit të kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe pas vlerësimit të pretendimeve të paraqitura në ankesat e ushtruara gjeti së:

-ankesat e mbrojtësve të të akuzuarës është pjesërisht e bazuar dhe atë sa i përket vendimit për dënim, kurse ajo e Prokurorit dhe mbrojtësve të të miturit nuk janë të bazuara.

**a).Pretendimet ankimore përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.**

Në ankesën e përbashkët mbrojtësit e të akuzuarës B.H., pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nenpar.1.12 të KPP, ngase dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe arsyetimin e tij dhe nuk ka prova për faktet dhe rrethanat që përshkruhen në të (kështu theksohet në ankesë). Kështu, mbrojtësit citojnë dispozitivin e aktgjykimit se ”...e akuzuara ka privuar nga jeta tani të ndjerin F.Sh. me dashje ..... në atë mënyrë që natën kritike e thërret në telefon të ndjerin dhe pasi që takohet me të, ashtu që e akuzuara se bashku me të miturin A.LL, me automjet....., janë nisur rreth orës 23 nga shtëpia e babait të saj në Pejë bëjnë disa xhiro dhe me të arritur afër banesës së saj ..... e sipas marrëveshjes paraprake e takon të ndjerin të varrezat e Kakariqit në Pejë e gjithnjë duke e joshur për lidhje dashurie, me propozimin e saj shkojnë në drejtim të banesës së saj, hyjnë brenda në fillim në korridorin e banesës pastaj përmes shkallëve shkojnë në tavanin e banesës në katin e dytë dhe në momentin kur ka hy brenda derisa e akuzuara ishte pas tij, ajo e nxjerr revolen e tipit të panjohur të kalibrit 7.65 x 17 mm e qëllon te ndjerin njëherë një herë nga poshtë lartë prapa shpinës , ai bie në dysheme pastaj e qëllon edhe tri herë në kokë duke i shkaktuar plagë vdekjeprurëse.....”, duke pretenduar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se e akuzuara dhe viktimja janë takuar të varrezat e Kakariqit, kur u takuan, si shkuan atje këmbë apo me çka shkuan? Nuk është vërtetuar me asnjë prove se kanë hyrë brenda në fillim në korridorin e banesës e pastaj në tavan. Pastaj, sipas pretendimeve të mbrojtësve të të akuzuarës gjykata ka konkluduar se viktimja është vërtetuar rreth orës 01:40 te mesnatës, ndërsa sipas akuzës viktimja është vërtetuar rreth orës 00:40, fakt ky që aktgjykimin e bën kundërthënë, ngase gjykata këtë përfundim e sjell në bazë të komunikimeve në mes të akuzuarës dhe viktimës, mirëpo, ky fakt nuk është vërtetuar, dhe në këtë drejtim gjykata nuk ka dhënë arsye bindëse. Kurse, mbrojtësit e të miturit përkitazi me këtë bazë ankimore pretendojnë se aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 pika 1.6 dhe 1.12 si dhe par.2 pika 2.1 të të njëjtit nen të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Sipas mbrojtësve, në këtë çështje, përkitazi me të miturin gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur kompetencë lëndore për të vendosur dhe lënda përkitazi me të është dashtë të ndahet dhe të gjykohet nga departamenti për të mitur-neni 21 par.2 të KPP. Sipas pretendime të ngritura në ankesë, Gjykata nuk e ka bërë vlerësimin e provave të administruara si mjete provuese, për ti paraqitur arsyet për të cilat gjykata e shkallës së parë ka konsideruar se ekzistojnë prova në bazë të të cilave është vërtetuar se i mituri i ka ndërmarrë veprimet inkriminuese të ndihmës në vrasje. Po ashtu, mbrojtja konsideron se Gjykata vetëm thekson se provat nga pika 6.1 deri në 6.14 dhe 7.1 deri në 7.15 të arsyetimit të aktgjykimit vërtetojnë se i mituri e ka ndihmuar të akuzuarën në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rendë duke i dhënë këshilla të akuzuarës se i ndjeri ka gisht në vrasjen e babait të saj, ka ndihmuar në takimin me viktimën, ia ka siguruar numrin e telefonit të viktimës, e ka ditë qëllimin e takimit, e ka qar në vendin e krimit dhe e ka pritë deri sa ajo e ka kryer vrasjen, e ka ndihmuar për ta mbështjellë trupin e viktimës, e ka larguar nga vendi i krimit dhe i ka premtuar fshehjen e krimit-kufomës, ashtu qe në bazë të kësaj ka ardhur në përfundim se i mituri ka kryer veprën penale, por nga përmbajtja e aktgjykimit nuk del se gjykata i ka

vlerësuar këto prova. Ajo në fakt, sipas ankesës vetëm ka përshkruar provat, ngase po ti kishte vlerësuar, atëherë, sipas mbrojtësve të të miturit, gjykata do të vërente se këto dëshmi në asnjë mënyrë nuk kanë të bëjnë me veprimet inkriminuese të lartpërmendura, të cilat fakte dhe rrethana nuk janë vërtetuar dhe as që kanë qenë objekt deklarimi nga këta dëshmitar. Në vazhdim, mbrojtësit pretendojnë se sa i përket veprës penale nga neni 291 par.1 të KPK, deklarata e të miturit e dhënë në polici, kur ka pranuar se dëshmitareve K.B., F.M. e L.H. iu ka thënë se e ka gjuajtur granatën e dorës në lokalit të T.D., është mbrojtje e dhënë në ndikimin e dhunës psikike dhe fizike të ushtruar nga F.M. dhe si e tillë është e papranueshme. Lidhur me këtë dëshmitë e dëshmitarëve K.B. dhe K.Sh.1 nuk janë dëshmi kredibile, sepse dëshmitari K.B. është dëgjuar vetëm në polici dhe të miturit dhe mbrojtësit të tij nuk ju ka dhënë mundësia që ta kundërshtojnë atë nëpërmjet marrjes në pyetje të dëshmitarit, kurse edhe dëshmia e dëshmitarit K.Sh.2 është mjaft konfuze dhe kundërthënëse me vetveten, ngase nuk ka dhënë dëshmi të njëjtë dhe përkundër kësaj, gjykata e trajton dëshminë e tij si të sigurtë. Sipas mbrojtjes, mungesa e arsytimit e bën aktgjykimin e pavlefshëm dhe si i tillë nuk mund të vlerësohet sepse në mungesë të arsytimit nuk mund të vërtetohet se çka ka dashur gjykata e shkallës së parë të thotë me atë aktgjykim.

Sipas pretendimeve të ankesës shkeljet nga par.2 pika 2.1 të nenit 384 të KPP qëndrojnë në faktin se shqyrtimi gjyqësor në pjesën me të madhe ka qenë publik edhe pse është dashur të jetë e kundërta, pra, jopublik, pasi që gjykata ka marrë aktvendim që shqyrtimi gjyqësor të jetë jopublik, por ky aktvendim nuk është revokuar. Përveç kësaj, sipas ankesës trupi gjykues nuk ka marrë vendim për bashkimin e procedurës dhe as që ka pasur propozim të prokurorit apo mbrojtësit në këtë drejtim.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë pretendimet e mësipërme ankimore nuk janë të bazuara.

Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat u referohen ankesat dhe as që ka shkelje tjera, të cilat, Gjykata kujdeset detyrimisht konform dispozitës së nenit 394 të KPP.

Ne fakt, pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarës përkitazi me këtë bazë ankimore me shumë i referohen gjendjes së fakteve ngase kontestohen faktet dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, për të cilat pretendojnë se nuk janë argumentuar. Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, në të janë përshkruar veprimet e të akuzuarës, dashja e saj për kryerjen e veprës penale të vrasjes në mënyrë dinake dhe për motive të hakmarrjes së paskrupullt, e të cilat veprime përbejnë qenien e veprës penale për të cilën e akuzuara është shpall fajtor. Ndërkaq, se a janë vërtetuar elementet e kësaj vepre penale, dhe a është e akuzuara kryese e kësaj vepre penale, do të behet fjalë në vijim të arsytimit, kur të flitet për gjendjen faktike, sepse vlerësimi i provave bie në kuadër të gjendjes faktike. Pretendimet e mbrojtësve përkitazi me kundërthëniet në mes të dispozitivit të aktakuzës dhe dispozitivit të aktgjykimit dhe kundërthëniet për sa i përket kohës (orës) së kryerjes së veprës penale janë të pabazuara, sepse përshkrimi faktik i ngjarjes i dhënë në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar përputhet në tersi me atë të dhënë në akuzë. Gjykata është e autorizuar që duke mos e prekur bazën faktike të ngjarjes të bëjë ndryshime në përshkrimin e ngjarjes ashtu siç rezulton nga provat e administruara nga shqyrtimi gjyqësor. Meqë ajo në bazë të provave të administruara ka konkluduar se viktimi është vrare rreth orës 1: 40 pas mesnatës, kjo nuk e bën aktgjykimin juridikisht të paqëndrueshme, sepse, përcaktimi i sakte i orës së kryerjes së veprës penale, në rastin konkret nuk paraqet ndonjë rrethanë të rëndësishme, nga e cili do të varej aplikimi i

ndonjë dispozite tjetër i ligjit penal dhe as që e mund të jetë me ndikim për pozitën penalo-juridike të të akuzuarës apo lëndën e akuzës.

Edhe pretendimet e mbrojtësve të të miturit përkitazi me këtë bazë ankimore nuk janë të bazuara. Së pari, të pabazuara janë pretendimet se gjykata nuk ka pasur kompetencë lëndorë ta gjykojë këtë çështje, ngase çështja përkitazi me të miturin është dashtë të veçohet dhe i mituri është dashtë të gjykohet nga departamenti për të mitur. Është evidente se sipas dispozitës së nenit 21 par. 2 të KPP ( i cili ka hyrë në fuqi me 1 janar 2013) kur një fëmijë është i pandehur në një rast penal, ai rast do të ndahet nga çdo rast tjetër dhe do të shqyrtohet vetëm nga departamenti për të mitur në kuadër të Gjykatës Themelore, sipas Kodit të Drejtësisë për të mitur. Mirëpo, Kodi i Drejtësisë për të Mitur si ligj special konkretisht nëni 47 par. 2 parasheh në mënyrë të veçantë, së procedura kundër të miturit mund të bashkohet me procedurën kundër të rriturit dhe mund të zbatohet në pajtim me dispozitat e përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për sqarim gjithëpërfshirës të rastit. Trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente merr vendim lidhur me këtë në bazë të propozimit të arsyetuar të prokurorit ose mbrojtësit.

Në rastin konkret bashkimi i procedurës është bërë sipas kërkesës së Prokurorit i cili ka marrë aktvendimin PPQ.nr.66/12 datë 14.05.2012 para se të hyjë në fuqi Kodi i Ri i Procedurës Penale për shkak të ndriçimit gjithëpërfshirës të rastit, prandaj pa bazë pretendohet se çështja për të miturin është dashtë të vendoset nga Departamenti për të mitur dhe se nuk është bërë bashkimi i procedurës në rastin konkret, ashtu siç pa bazë pretendohet se i terë shqyrtimi gjyqësor është dashur të jetë jopublik.

Lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë përkitazi me mospërfshirimin e publikut nga një pjesë e seancës së shqyrtimit gjyqësor, është me rëndësi të theksohet së sipas dispozitës së nenit 294 par.1 par.1.5 të KPP parashihet se që nga fillimi e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, mund ta përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij kur kjo është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe gjykata duke bazuar në këtë dispozite por edhe në dispozitën e nenit 71 të KDM ka vendosur që vetëm një pjesë e shqyrtimit gjyqësor (disa seanca që kanë të bëjnë me të miturin) të jenë jopublike për çka ka marrë aktvendim të veçantë dhe pas mbajtjes së këtyre seancave ka revokuar vendimin (aktvendimi P.nr.04/2013 datë 25.06.2013), prandaj edhe pretendimet se nuk është revokuar aktvendimi janë të pabazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, edhe pse me ankesë pretendohet së gjykata e shkallës së parë vetëm i ka cituar provat me numra (fakt i cili qëndron), megjithatë, arsyetimi i aktgjykimit përmban arsye të mjaftueshme e të qarta përkitazi me faktet vendimtare të kësaj çështje juridiko penale, veprave penale për të cilat është ngarkuar dhe shpall përgjegjës i mituri, përgjegjësinë e tij penale dhe aplikimin e ligjit penal. Në këtë drejtim gjykata vlerësimin e provave e ka bërë konform dispozitave ligjore duke dhënë arsye se cilës prove ia ka fale besimin e cilës jo, duke vlerësuar edhe mbrojtjen e të miturit në të gjitha fazat e Procedurës dhe ka paraqitur konkludimet e veta të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, dhe në këtë drejtim përkitazi me vlerësimin e provave me shumë do të behet fjalë në kuadër të gjendjes faktike, prandaj pretendimet e paraqitura në ankesë në këtë drejtim janë të pabazuara.

Duke pasur parasysh faktin se deklarata e të miturit e dhënë në polici sa i përket veprës penale nga neni 291 par.1 te KPK është marrë konform dispozitave ligjore në prezencë të mbrojtësit, sipas vlerësimit të kësaj gjykatë, ajo është e pranueshme në procedurë për tu mbështetur aktgjykimi në të, ngase nga shkresat e lëndës nuk rezulton asnjë indikacion se i mituri gjatë marrjes ne pyetje ne stacionin policor është detyruar që të deklaroj diçka që nuk e ka bërë.

Nga ana tjetër, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, qëndron fakti se dëshmitari K.B. ka dëshmuar vetëm ne polici dhe se deponimi i këtij dëshmitari i dhënë ne polici është lexuar ne shqyrtimin gjyqësor, mirëpo, duke pasur parasysh faktin se deponimi i dëshmisë se këtij dëshmitari është lexuar ne shqyrtimin gjyqësor edhe me pëlqimin mbrojtësve të të miturit dhe nuk është e vetmja dëshmi ne te cilën gjykata e mbështet aktgjykimin sa i përket kësaj vepre penale, pa bazë aludohet se edhe dëshmia e këtij dëshmitari është e papranueshme.

#### **b) pretendimet sa i përket gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal.**

Sa i përket gjendjes faktike mbrojtësit e të akuzuarës pretendojnë se në rastin konkret gjykata nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, seps, sipas ankesës provat të cilat janë administruar nuk i plotësojnë as kriteret e provave rrethanore e lerë më të provave bazë për shpalljen fajtores të të akuzuarës dhe gjykimin e saj me 29 vite burgim. Në ankesë thuhet se gjykata në përpjekje për vërtetimin e tërësishëm të gjendjes faktike ka administruar prova dhe ka shfrytëzuar dëshmitë e dëshmitarëve të cilët i ndan ne të “ndershem, shumë të ndershem dhe të besueshem”, dhe dëshmitar “jorelevant”, por nga dëshmitë e tyre nuk arriti asgjë të vërtetohet, përkundrazi, sipas mbrojtësve, gjykata me shumë e ngatërroj së sa e qartësoi gjendjen faktike. Kështu, sipas ankesave gjykata i dëgjoi (deponimet e disa dëshmitareve u lexuan ne shqyrtimin gjyqësor) 17 dëshmitar, por nga dëshmitë e tyre ( në ankesa theksohen të gjithë dëshmitaret e kësaj çështje, vlerësimet e gjykatës përkitazi me dëshmitë e tyre), në asnjë rast nuk u vërtetua asnjë element që do ta inkriminonte të akuzuarën në drejtim të veprës penale për të cilën është shpallë fajtores. Pastaj, mbrojtësit me ankesë theksojnë mbrojtjen e të akuzuarës në të gjitha fazat e procedurës. Kështu, theksojnë se ajo për herë të parë kur është marrë në pyetje është mbrojtur në heshtje, e kur është dëgjuar me 12.05.2012, ajo ka pohuar se e ka kryer vrasjen për shkak se ishte e dhunuar nga viktimi, ndërsa në deklaratën e dhënë me 29.05.2012 ajo ka sqaruar qartë se deklaratën e dhënë me parë e ka dhënë nën kërcënimin e të miturit, kurse në mbrojtjen e saj të dhënë në prokurori me 20.11.2012 ajo ka dhënë sqarime në detaje se pse ka deklaruar se ka kryer një vepër të cilën në fakt nuk e ka kryer. Ne fakt, mbrojtësit në këtë drejtim vetëm citojnë mbrojtjet e të akuzuarës pa ndonjë pretendim të caktuar, por nga përmbajtja e ankesës del se në këtë drejtim pretendojnë se e akuzuara nuk është kryerëse e veprës penale dhe se mbrojtjes se saj të dhënë në Prokurori është dashur gjykata t’ia falë besimin, duke shtuar se në rastin as motivi i hakmarrjes për vrasjen e babait të saj, si motiv për kryerjen e vepres penale nuk është vërtetuar dhe as i mituri në mbrojtjen e tij nuk e inkriminon të akuzuarën.

Me ankesë mbrojtësit i kontestojnë edhe provat materiale të administruara ne këtë çështje juridiko-penale, duke pretenduar se as me to nuk është vërtetuar asnjë fakt që e involvon të akuzuarën në kryerjen e veprës penale, duke shtuar se gjykata pa bazë nuk e vlerësoj si provë me peshë letër-dorëshkrimin te prezantuar nga mbrojtja nga e cila vërtetohet presioni që i është bërë të akuzuarës për të pranuar veprën penale në mënyre që

të lirohet i mituri. Dhe si rezultat i vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes së fakteve nga ana e gjykatës së shkallës së parë ajo e ka shkelur ligjin penal në dëm të akuzuarës kur ka konkluduar se në veprimet e të akuzuarës janë përmbush tiparet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 3 e 9 të KPK.

Nga ana tjetër edhe mbrojtësit e të miturit pretendojnë se gjykata nuk e ka vërtetuar drejt dhe në mënyre të plotë gjendjen faktike për të dy veprat penale për të cilat është shpall përgjegjës, duke theksuar së përfundimet e gjykatës në bazë të provave të administruara janë të gabuara. Në këtë drejtim, pretendimet ankimore përkitazi me këtë bazë, me shumë i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat janë theksuar dhe arsyetuar me lartë në kuadër të kësaj bazë ankimore.

Sipas mbrojtësve, meqë gjykata nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike ajo e ka shkelur ligjin penal kur të miturin e ka shpall përgjegjës për veprat penale të cilat i janë ngarkuar me propozimin për dënim. Veçmas potencojnë se vepra penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 3 e 9 të KPK ekziston vetëm nëse ndihma jepet para ose gjatë kryerjes së veprës penale, derisa nuk përfundon kryerja e veprës, por edhe pas kryerjes së veprës penale po që se ndihma është premtuar para se të fillojë të kryhet vepra. Sipas mbrojtësve, në rastin konkret, i mituri në propozimin për shqiptimin e dënimit ngarkohet se ndihmën e ka dhënë pasi që e akuzuara e kishte kryer vrasjen, rrethanë kjo e cila është pranuar edhe nga gjykata. Prandaj, meqë kjo ndihmë është dhënë pasi që është kryer vepra ndërsa, nuk është vërtetuar se i mituri ia kishte premtuar me parë të akuzuarës këtë lloj ndihme- para se të këtë filluar kryerjen e veprës penale, sipas mbrojtësve, ky veprim i të miturit edhe nën supozimin që të jete vërtetuar nuk mund të konsiderohet si ndihmë.

Ndërsa, për ekzistimin e veprës penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par.1 të KPK duhet që rreziku të jetë konkret dhe thelbësor dhe se në realitet i është shkakuar jetës së njerëzve të caktuar dhe pasurisë konkrete të një rëndësie thelbësore. Meqë, në dispozitivin e aktgjykimit në përshkrimin e kësaj vepre penale nuk theksohet jeta e cilëve personave është rrezikuar dhe pasuria e një rëndësie thelbësore as që është vërtetuar, sipas mbrojtësve në veprimet e të miturit nuk qëndrojnë elementet e figurës së kësaj vepre penale.

Edhe këto pretendime sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë nuk janë të bazuara.

Në këtë çështje nuk është kontestuese se i ndjeri F.Sh. është gjetur i vdekur në banesën e të akuzuarës (tavanin e banesës) e cila gjendet në rrugën “Papa Klementin”, nr.95, dhe se vdekja e tij është pasojë e dëmtimit të strukturave trupore, gjakderdhjes së jashtme dhe të brendshme, dëmtimit të mëlçisë dhe mushkërive si rezultat i veprimit dinamik të predhëve të hedhura nga arma e zjarrit.

Në këtë çështje penale nuk është kontestuese as fakti se më 20.02.2012 në lokalitetin zeytar-pronë e të dëmtuarit T.D. është hedh një granatë dore.

Kontestuese është fakti se a e privoi e akuzuara nga jeta tani të ndjerin F.Sh., respektivisht a qëndrojnë në veprimet e saj elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika pika 3 e 9 të KPK për të cilën është shpallë fajtores dhe a e ndihmoi i mituri A. të akuzuarën në kryerjen e kësaj vepre penale, dhe së fundi a është i mituri edhe kryes i vepres penale nga neni 291 par.1 të KPK ?

Siç del nga shkresat e lëndës në mes te babait të të akuzuarës dhe të dëmtuarit T.D. kishte një konflikt rreth një lokali zejtar- pronë e te dëmtuarit. Pas hedhjes së granatës ne lokalin e të dëmtuarit me 20.02.2012, edhe shtëpia e babait të të akuzuarës është gjuajtur me mjete shpërthyes, nga i cili shpërthim babai i te akuzuarës ka pësuar lëndime nga te cilat edhe ka vdekur. Pas lëndimit të babait të saj e akuzuara është kthyer nga Amerika dhe ka jetuar tek familja e saj. Gjatë kësaj kohe është shoqëruar me të miturin me të cilin është në raporte familjare ( nënat i kane vajza te axhës).

Nga shkresat e lëndës gjithashtu rezulton se më 2.05.2012 familja e te ndjerit F.Sh. e ka lajmëruar të ndjerin si person të zhdukur pasi që pas daljes se tij nga shtëpia me 1.05.012 rreth orës 23:00, ai nuk ishte kthyer më.

Sipas dëshmisë se dajës se të ndjerit -dëshmitarit F.M. del se Fd. me 1.05.2012 kishte qenë në punë prej orës 3 deri në 7 e 30 në thertoren “Buquku” në Pejë, ne te cilën kane punuar qe të dytë. Gjatë ditës kishte qenë në piknik për festën e 1 majit me disa shokë. Të njëjtën ditë rreth orës 18:00 është kthyer prapë në punë dhe kishte punuar deri në 19 e 15 minuta. Sipas këtij dëshmitari atë ditë Fd. i kishte treguar se ishte duke folur me një femër në telefon dhe ajo po kërkonte që të del me të, dhe se me këtë femër kishte lenë takim në orët e vona të natës. Kur i ndjeri i kishte thenë kështu, ky i ishte përgjigjur se nuk dilet në atë kohë me femra, por ai i është përgjigjur se ajo i kishte thënë se i ka vëllezërit e vështirë dhe nuk mund të dal herët. Fd. është dashtë të kthehej në punë pas mesnate përkatësisht me 2.05.2012 në ora 3 por nuk ishte kthyer. Meqë Fd. nuk ishte kthyer në punë sipas orarit, dëshmitari M. e kishte thirrur te ndjerin ne dy telefonat qe posedonte njërin te Valës dhe tjetrin te IPKO-s por nuk i ishte lajmëruar. Në mëngjes e kishin lajmëruar zhdukjen e tij në polici. Së bashku me dëshmitarin K.B., ai ia kishte kontrolluar facebookin te ndjerit, dhe kishin vërejtur se i ndjeri kishte komunikuar ne facebook me te miturin A.. Në facebook A.i i kishte shkruar Fd. “ A ke dalë me atë bukuroshen, ky është numri i saj, kape thirre”. Se bashku me K. ishin marre vesh qe te takoheshin me A.in, por para se te takoheshin me te e kishin lajmëruar policinë. Në takim A.in e kishte pyetur për Fd.n dhe i mituri i kishte thënë “se nuk është ma”. Meqë ishte ne veture e ka ndale veturën, kishte humb kontrollin por meqë policet kane qene pas tyre nuk e kane lejuar ta rrahin.

Nga rrjedha e mëtejme e ngjarjes rezulton se pas ndërhyrjes së policisë në takimin e dajës së të ndjerit me të miturin, është arrestuar i mituri dhe ne mbrojtjen e tij te dhënë ne polici ne prezence te mbrojtësit nen dyshimin për gjuajtjen e granatës dhe zhdukjen e viktimës ai ka deklaruar se me 2.05.2012 është takuar me K.B. dhe K.Sh.1 te cilët e kane pyetur rreth Fd. dhe ju ka thënë se e ka pare para tre - katër ditëve. Sipas te miturit ata e kanë pyetur se: “a e ke gjuajtur bombën ti me Fd.” ky ju kishte thënë “po”. Pastaj ka shkuar te shtëpia e S.K.t. Të nesmrën kishte dale me vajzën e S. - B. dhe kishin shkuar në Prishtinë, nga janë kthyer rreth orës 21. Gjate rrugës është ndale për tu takuar me K.B., ka hyrë në veturën e tij ne te cilën ishte Qrr. dhe Ft. –daja i Fd.. Se ne fillim ata kane folur mire me te, pastaj Ft. e ka kap për fyti dhe i ka thënë “se ke me pjelle Fd.” dhe e ka grushtuar me boksa, por Korabi e ka larguar, pastaj ka intervenuar policia dhe e kane arrestuar. Gjate rrugës policet e kane pyetur se: “a e ke gjuajtur ti bombën” dhe ai ju ka thënë “po”. Nuk e ka gjuajtur bombën, ndërsa, policisë ju kishte thënë “se e ka gjuajtur ngase Qrr. ne prezencën e e policisë e kishte pyetur a e ke gjuajtur bombën dhe ai i kishte thënë po”. Me Fd. kishte një muaj qe nuk kishte komunikuar, ndërsa, me 1.05.012 kishte qene ne Rugovë me familjen e S.K.t dhe se arsyeja qe shoqërohej me vajzën e tij -B. ishte fakti se atë e kishte te familjes.



Dëshmitari L.H. përkitazi me takimin me te miturin A. nder te tjera ka deklaruar se përderisa Fitimi voziste me veturën e tij, janë takuar me A.in i cili ka hyrë në veture dhe kur e ka pyetur për Fd.n ai është deklaruar “unë nuk e kam vra Fd.n por ai nuk është ma”. Por, kur është pyetur i mituri se a i ke borxh Fd.t ai fillimisht është deklaruar se nuk i ka, por pastaj i ka thënë se i ka borxh dhe se ai e kishte gjuajtur bombën ne dugojen e T.D.t, ndërsa Fd. e ka ruajtur gjate gjuajtjes se bombës, gjatë bisedës e kishin pyetur edhe për numrin e telefonit ne facebook dhe se ai kishte deklaruar se është numri i një femre nga Prishtina.

Dëshmitari K.B. në këtë drejtim ka deklaruar se një dite para zhdukjes, kishte qene me te ndjerin kur ai kishte folur me A. në telefon. Fd. i kishte thënë këtij dëshmitari se A.i ia ka do pare borxh. Pas zhdukjes se tij nga daja i tij Fitimi kishte mësuar se Fd. kishte komunikuar me A. ne facebook. A. e kishte pyetur se a i ke borxh para Fd.t, por ai i është përgjigjur “po por as unë si kam marr”, dhe kur e kishte pyetur se për çfarë behet fjale ai është përgjigjur” e kemi kryer një pune me Dn., ne e kemi gjuajtur bombën te shtëpia e mallrave”. Pasi qe ishte takuar me te se bashku me Ft. dhe K. e kishte pyetur për numrin e telefonit ne facebook dhe ai është përgjigjur se është i femrës se tij dhe kishte pranuar se e kishte gjuajtur bombën. Dëshmitari K.Sh.2, shok i ngushtë i të ndjerit, përkitazi me këtë ngjarje, në dëshminë e tij ka deklaruar së para gjuajtjes së bombës kishte dëgjuar bisedën kur A. në prezencën e tij kishte biseduar me Fd. për lokalit e S.K., duke thënë se atë ia ka marrë me “reket” njëfarë D.. Gjatë bisedës rreth gjuajtjes se bombës A. e kishte ftuar edhe atë qe ta përcjell gjatë kryerjes së asaj pune, dhe për këtë nuk i kishte ofruar ndonjë shpërblim, por ky nuk kishte pranuar. Dëshmitari ka thënë së ua kishte parë bombën në një këse te plastikes dhe pasi qe i kishin thënë se “po shkojmë ta kryejmë këtë pune”, deklarimet e tyre i kishte marrë si shaka, ndërsa, pasi që kishte shkuar ne një lokal larg lokalit ku ishte gjuajtur bomba rreth orës 20:00 kishte dëgjuar krisma. Me 01.05.012 kishte qenë se bashku me Fd. dhe disa tjerë ne shëtitje dhe pas dite kishte shkuar në shtëpinë e Fd.. Fd. i kishte treguar se duhej të shkonte në punë në ora 3 pas mesnatës, por po ashtu e kishte njoftuar se po komunikonte me një femër në telefon me mesazhe dhe se kjo femër i kishte kërkuar takim në orët e vona të natës. Atë natë ishte ndarë nga Fd. rreth orës 23:00, por gjatë bisedës me te ai i kishte thënë se “nëse me gjen diçka, dije se e kam prej vajzës se S.K. dhe A. Ll.”. Të nesërmen pasi qe është njoftuar se Fd. s’ ishte kthyer, ky dëshmitar ishte takuar me A.in dhe e kishte pyetur se a din gjë për Fd.n.

Nga kjo rezulton se pas arrestimit të të miturit është arrestuar edhe e akuzuara dhe me 8.05.2012 në polici ajo është mbrojtë në heshtje. Kurse vëllai i të akuzuarës K.K. me datë 12.05. 2012 (përkundër asaj se ai kishte dëshmuar me 11.05.2012) ishte lajmëruar vet në polici dhe në prezencë të mbrojtësit ka deklaruar se kur është arrestuar B. ka qenë i sigurt se është e pafajshme, por kur e ka vizituar ne burgun e Lipjanit motra e tij ia kishte pohuar se kishte dore në zhdukjen e Fd. dhe i kishte treguar se trupi i tij ndodhej ne tavanin e banesës se saj tek Stacioni i trenit. Dhe pas dhënies se dëshmisë se këtij dëshmitari është gjetur edhe kufoma e të ndjerit, dhe të njëjtën ditë e akuzuara ka dhënë deklaratë në polici në prezencën e mbrojtësit te saj me ç’rast e pranon veprën penale por, duke theksuar se këtë vepër e ka kryer për shkak se i ndjeri e kishte dhunuar, dhe se për rastin e dhunimit nuk e kishte lajmëruar askënd deri në momentin kur pas arrestimit e kishin vizituar nëna e vëllai Kastrioti, me ç’rast atyre ju kishte treguar se është hakmarrë për shkak të dhunimit. Në këtë deklaratë ajo përshkruan mënyrën se si e ka kryer veprën penale duke theksuar se “ditën e varrimit të babait të saj (19.04.012) e kishte parë Fd. i cili kishte shkuar për ngushëllime. Pas dhjetë ditësh kishte komunikuar me të vetëm në telefon duke i shkruar mesazhe e shumë pak duke folur me qëllim që mos ta njihte,

numrin e tij e kishte marr nga A. dhe ka komunikuar me te me qëllim që të takohej me të dhe ti hakmerrej. Me 1 maj 2012 është marrë vesh përmes telefonit me të dhe kanë lenë takim te varrezat e Kakariqit në Pejë. Rreth orës 23 e 30 minuta në mbrëmje nga A.i ka kërkuar që ta shoqëronte me veturën e tij që e kishte marrë me qira tek “Shpendi” në Pejë. Pasi që kanë bërë disa xhiro me automjet në qytet, kur kanë arritur te floktari “NNi”, që gjendet tek varrezat e Kakariqit më qëllim që A.i mos ta kuptonte se do të takohej me Fd. i kishte thënë se do të shkonte tek shtëpia e burrit të saj që të merrte diçka dhe kur ajo ta thërriste te shkonte ta merrte. Pas pak minutash Fd. kishte shkuar me taksi dhe pasi që kishte zbritur nga taksi kishte komunikuar me të, është takuar me te dhe ju kishte prezantuar si Ana. Pas bisedës me te i kishte thënë që të shkonin në banesën e gjyshes së saj, ngase kishte për qëllim që të qonte në banesën e burrit të saj në të cilën nuk banonte askush. Kur kanë shkuar në banesë i ka thënë që të ngjiteshin në tavan ngase ishte dikush në banesë. Pasi që ka hyrë ne tavanin e banesës i pari është ulur Fd. nga brezi ka nxjerrë një armë të zezë e ka qitur në tavolinë në anën e djathë të tij. Ai e ka ndez një cigare, e ka lutur edhe atë, ndërsa ajo i është përgjigjur se ika te sajat. Meqë ka qenë pas tij është bërë sikur po kërkonte cigaret ka marrë revolen e tij dhe e ka gjuajtur pas shpine, pastaj pasi që ka ra në shpinë ia ka drejtuar armën tek koka e tij dhe ka gjuajtur në të edhe disa herë por nuk din se sa herë. Pastaj në korridor ka marr një peshqir dhe e ka mbështjellë armën, të cilën pastaj e ka mbështjellë me qese të najlonit të bardhë, ndërsa një këse tjetër ia ka futur në kokë më qëllim që mos ti pikë gjaku dhe pastaj e ka mbuluar më një plaf. Ia ka marrë telefonin dhe i ka marrë edhe disa dokumente të babait te saj që kanë qenë në çantë”. Pas kryerjes së vrasjes ka shkuar në tualet, e ka ndërruar xhemperin pasi që kishte pika gjaku. Pas kësaj e ka ftuar A. në telefon dhe kanë shkuar në shtëpinë e babait të saj. Për këtë nuk i kishte treguar askujt asgjë. Të nesërmen me 2.05.2012 kishte ardhë prapë në këtë shtëpi e ka marrë armën të cilën e ka çmontuar dhe e ka hedhur në lumë në kilometrin e pestë në Rugovë. Xhemperin me gjak e ka gjuajtur ne bërllok – kontejner te Peja Cyti. Kur kishte shkuar të marrë armën ka dëgjuar që të ndjerit i ka cingëruar telefoni në vibrim dhe nga xhepi i tij ka marrë edhe këtë telefon dhe kuletën dhe që të dyja i ka copëtuar dhe i ka gjuajtur në një tunel afër hotelit “Dona”, ndërsa telefonin tjetër të Fd. që ia ka marrë e ka gjuajtur gjatë rrugës për në Prishtinë me 2.05.2012”.

Nga shkresat e lëndës del se me kërkesën e saj, e akuzuara në prezencën e mbrojtësit të saj e ka dhënë edhe një deklaratë në polici me 29.05.2012, mirëpo ajo tani e ndryshon versionin e mbrojtjes se saj duke theksuar se pranimin e veprës penale e ka bere nga kërcënimi që ia ka bere i mituri A.Ll., ngase ai e ka vrarë të ndjerin. Ajo ndër të tjera ka theksuar se pasi që i është plagosur babai i saj është kthyer nga Amerika dhe se gjatë vizitës së babait të saj në Spital, është njoftuar me A. Ll. të cilin e ka tezak, dhe me të është shoqëruar vazhdimisht dhe ka pas raporte të mira. A.i ka shpreh interesim për rastin e babait të saj. Të ndjerin nuk e ka njohur me parë, se A.i ia kishte treguar fotografinë e Fd.t ne facebook dhe i kishte thënë se ky njëri është vrasësi i babait tënd. A.i ia kishte blerë numrin e telefonit, ai i kishte kërkuar që kjo ta joshte atë, i kishte shkruar Fd.t mesazhe në emër të saj. A.i i kishte treguar se me Fd.n ishte në grup dhe se ky nga A.i kërkonte para për disa pune që i kishte kryer me te, ngase A. se bashku me Fd.n e kishin gjuajtur granatën e dorës tek dyqani i T.D.t. Sipas të akuzuarës i tërë plani ka qenë i A.it i cili i ka thënë së nëse ndodh diçka duhet me thënë se Fd. të ka dhunuar. Se vrasjen e të ndjerit e kishte bërë A., se ai kishte kërkuar nga ajo që ta ndihmonte, se ai e kishte mbështjellë më qesë të najlonit, se A. e kishte hedhur revolen në lumë, se kur kanë shkuar në Prishtinë e kanë biseduar çështjen e Fd.t se ai i kishte thënë që t’ia linte këtë çështje atij ngase do të merrej vesh me disa shokë për ta larguar trupin e të ndjerit.

Në deklaratën e saj të katërt të dhënë në polici nder të tjera ajo shton se në deklaratën e mëparshme kur ka deklaruar se armën e kemi hedhur në lumë, e vërteta është se atë armë nuk e ka pa dhe nuk e din ku e ka lënë A., ai nga ajo ka kërkuar një peshqir për ta mbështjell të cilin ia ka dhënë, edhe telefonat e viktimës pas vrasjes i ka marrë A.. Nuk ka qenë prezent kur A.i e ka qëlluar me armë, por nën kërcënimin e A. është detyruar ta ndihmoj ta mbështjell kufomën.

Në mbrojtjen e saj të dhënë në Prokurori ajo pjesërisht i pohon veprimet e saj deri ne momentin kur ka shkuar në banesë dhe pas daljes nga banesa. Ndërsa, edhe në shqyrtimin gjyqësor versionin se si është zhvilluar ngjarja e jep ndryshe, madje edhe mënyrën e kërcënimit nga i mituri. Kështu, ajo thekson se natën e ngjarjes kur kishte dal me A.in, kur kane shkuar tek floktari “NNi”, janë ndal dhe A. i kishte thënë qe ta priste se kishte për te kryer një punë. Ajo e kishte pritur rreth një orë e gjysmë dhe kur A. ishte kthyer kishte vërejtur që ai ishte i shqetësuar. Se të nesërmen kur kishin shkuar në Prishtinë ai me gjakftohtësi i kishte thënë se personin qe është zhdukur Fd.n e kishte vra, dhe në pyetjen e saj se qysh e ke vra? A.i i është përgjigjur “po more i kam shpëtuar njëzet mijë euro”. Sipas të akuzuarës i mituri i kishte thënë se kur e ka vra Fd.n ka qenë edhe një femër dhe nëse zbulohet vrasja e tij ti duhet me e pranuar veprën penale, ndërsa kur kjo i është përgjigjur se qysh me pranua diçka që nuk e ka bërë ai i kishte thënë “puna asht me keq ti mos u tut, po te tregoj se trupi i atij personi që është vrarë është në banesën tende, se ka një shok nga Gjilani që është ekspert për këtë punë, do ta thërras dhe ai do ta marrë trupin nga banesa, ndërsa, kur i është përgjigjur kjo se do ti tregonte policisë i mituri është tmerruar dhe iu ka kërcënuar se duhet ta pranoj veprën dhe ia ka dhënë një letër dhe i ka thënë se këtu e ke te shkruar se çka duhet te thuash, ma mirë për ty se ndryshe të shkon e gjitha familja jote. Ne letër ka qene e shkruar krejt ajo çka ka deklaruar ne polici herën e parë.

Dëshmitari K.K.- vëllai i të akuzuarës pas dhënies se dëshmisë në polici me 11.05.201 dhe 12.05.2012, del se ka dhënë edhe një deklaratë në polici edhe me datën 16.05.012 duke shtuar se “ pasi që Bt. e ka informuar se ku gjendet trupi i viktimës dhe e ka pyetur se pse e kishte bërë këtë ajo është përgjigjur ” Fd. e ka vendos bombën në shtëpinë tonë kur është vra babai ynë”. Sipas Besartës ajo bombë ka qenë arsyeja qe ajo e kishte vra F.Sh.”. Ne shqyrtimin gjyqësor ky dëshmitar i mohon deklaratimet e tij te dhëna me 12.05.2012 dhe 16.05.2012.

I mituri në mbrojtjen e tij e ka mohuar se e ka ndihmuar te pandehurën në kryerjen e kësaj vepre penale. Ka theksuar se që kur e kanë përjashtuar nga shkolla në kolegjin Amerikan për shkak te raporteve me babanë e tij kishte jetuar te tezja në Prishtinë, pastaj në Pejë te familja e S.K.t. Fd.n e njihje që 7-8 vite, kanë jetuar në të njëjtën lagje dhe është shoqëruar me te. Pas shkuarjes në Prishtinë nuk ka pas shumë kontakte me te. Kontaktet me te i ka shtuar 2-3 muaj para zhdukjes. Bisedat kanë qenë rreth një revole të cilën Fd. është munduar t’ia shes dhe nga ajo kohë i ka kërkuar nga ai 200€. Me B. është shoqëruar dhe raportet me te i ka pas të mira, ngase i ka qëndruar afër kur i është lënduar babai. Pranon faktin se natën e ngjarjes kur është kryer vrasja, ka dalë me të pandehurën pas orës 23,00 në qytet, por sipas tij kinse, për të blerë bukë. Se ka shkuar me te deri afër banesës së saj, ngase e akuzuara kishte kërkuar që të shkonte ne banesën e saj për të marrë disa sende. Sipas tij ai e kishte pritur atë derisa ajo e kishte telefonuar që të shkonte, se kishte shkuar dhe hyrë në korridor te banesës dhe kishte qëndruar derisa e akuzuara kishte marrë çantën dhe dy këse me tesha, pastaj janë nisur për në shtëpinë e Besartës, tek familja e saj, se gjatë rrugës Bt. ka kërkuar nga ai që ta ndal automjetin tek kontejnerët e bërllokut në rrugën ne drejtim te Peja City-it dhe ajo ka hedhur një këse në

bërlllok, por nuk e din se çka ka pasur në atë këse. Pastaj janë shkuar tek shtëpia e babait të saj-S.K.t, ndërsa rrugës e akuzuara e ka thirr vëllain e saj në telefon, meqë ai nuk i është përgjigjur e ka thirr Et. i cili e ka hapur telefonin dhe i ka thënë që t'ia hap derën e pasme të shtëpisë ndërsa, kur janë kthyer ka qenë ora 3:00 pas mesnatë

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate përfundimi i gjykatës se shkallës se parë se e akuzuara është ekzekutore e vrasjes së të ndjerit, se të ndjerin e privoi nga jeta në mënyrë dinake dhe për motive të hakmarrjes se paskrupullt është i drejtë ngase deklarimit i të akuzuarës në polici me 12.05.2012 përkitazi me mënyrën e kryerjes së veprës penale është në përputhshmëri dhe korrespondon edhe me provat materiale të proceduara në këtë çështje juridiko penale. Kështu, nga të dhënat mbi thirrjet telefonike-hyrjet –daljet dhe mesazhet vërtetohet se e akuzuara prej 20.04.2012 e deri me datën e arrestimit të saj ka poseduar dy numra të telefonit 045-....dhe 045-...( me këtë të fundit ka komunikuar vetëm me të ndjerin), i mituri ka poseduar tre telefona 044-..., 044-... dhe 049-..., ndërsa i ndjeri ka poseduar dy numra 049-... dhe 045-..., pra i ndjeri posedonte dy telefona ashtu siç ka deklaruar dëshmitari F.M. dhe vet e akuzuara të cilët ia kishte marr pas privimit nga jeta. Nga raporti i listingut të dhëne nga Zyra Ligjor e Kompanisë Vala datë 8.05.2012, vërtetohet se e akuzuara Bt. në vazhdimësi gjatë periudhës së lartcekur ka komunikuar dhe shkëmbyer mesazhe me të miturin, në njërin nga këto mesazhe i mituri i shkruan “ spo di duhet me e afru shume, kishe na po e dojm edhe ai e ndal gojën dhe mendon se po e dojm shume, e hane foren e ndihet Boos dhe e hane mutin e vet”. Sipas raportit të autopsisë del se viktima ka pas tri plage në kokë dhe një në anën e djathtë të kafazit të kraharorit në nivelin e vijës së mesme sqetullore rreth 30 cm larg nga vija e mesme e trupit rreth 40cm ( e akuzuara ka deklaruar se njëherë e ka gjuajt pas shpine dhe tri herë në kokë) dhe se vdekja e tij është e dhunshme si pasoje e dëmtimit të strukturave trupore e si rezultat i veprimit dinamik të predhave të hedhura nga arma e zjarrit. Nga raporti i zyrës ligjore Vala datë 10.05.012 del se e akuzuara ka shkëmbyer mesazhe edhe me të ndjerin. Nga përmbajtja e mesazheve të fundit del se e akuzuara ka kërkuar që të takohet me të ndjerin në orët e vona të natës –përmbajtja e mesazhit “ loçko un po e bëje punën veç hatri i yt me u pa sonte, a mo duna sa më vonë me dal e kallxom kur mundesh ti, por sa më vonë, mpuq”( ashtu siç ka pohuar ajo vet), e i cili fakt nuk vërtetohet vetëm nga transkriptet e mesazheve, deklarimi i të akuzuarës por edhe nga deklaratat e dëshmitarëve. Në tavanin e banesës së saj viktima është gjendur i shtrirë i mbështjell me najlon dhe batanije ashtu siç ka pohuar e akuzuara. Nga raporti nr.2012DA-0791-2012XP-069 datë 9.05.2012 mbi bazën e të dhënave nga raportet e Kompanisë “IPKO” dhe kompanisë “Vala”, për thirrje telefonike dhe hartografi vërtetohen komunikimet në mes të të akuzuarës dhe të ndjerit dhe vendi i komunikimit, si dhe komunikimet e të akuzuarës me të miturin dhe personat tjerë (vëllain e saj Kastriotin dhe dëshmitarin Elton Arifaj) natën e ngjarjes, prova këto që korrespondojnë edhe me mbrojtjet e të miturit dhe të akuzuarës. Nga lista e dëshmitëve e përpiluar në vendin e ngjarjes nga ekspertiza e Ministrisë së Punëve të brendshme AKF-Ministra për Ekspertim Transelgjik-Daktiloskopik nr.AKF/2012 -1401/2012 -1212 datë 9.07.2012 del se në dëshminë 28-pjesë e plastikës ngjyrë e zezë janë gjetë gjurmë të vijave papilare të cilat janë fiksuar me inicialet C6.C7 C8 C9 C10 dhe C11 dhe është konstatuar se inicialet C6, C9 e C10 mund të krahasohen me personat B.H. e A.Ll., dhe krahasimi ka dhënë identifikimin përputhshmërinë e gjurmëve C6 e C9 me personin A.Ll.. Iniciali C6 përputhet me gishtin numër nëntë-gishti i unazës, dora e djathtë, ndërsa iniciali C9 përputhet me shenjëën e gishtit 3 –gishti i mesëm i dorës së djathtë të personit.

Prandaj, duke pasur parasysh këto prova materiale, pa asnjë mëdyshje rezulton se e akuzuara e ka privuar nga jeta të ndjerin, kurse fakti se ajo pranimin e veprës e ka bërë

nën kërcënimin e të miturit sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë është përpjekje perfide e saj për ta mbuluar fajin. Pranimit nën trysinë e kërcënimit edhe po të ishte i tillë nuk do të mund të përputhej në përpikëri me të gjitha detajet dhe rrethanat e ngjarjes së zhvilluar. Ndërsa, duke pasur parasysh ecurinë e ngjarjes, versionet e mbrojtjes së të akuzuarës (pas pranimit të veprës në polici me 12.05.2012) dhe provat tjera të administruara në këtë çështje me hollësisht të përshkruara dhe të arsyetuara në aktgjykimin e kundërshtuar, veçanërisht dëshminë e dëshmitarit K.S. të dhënë në polici me 16.05.2012 del qartë se motivi i të akuzuarës për ta privuar nga jeta të tani të ndjerin Fidan ishte hakmarrja ndaj vdekjes së babait të saj, për çka ajo e privoj nga jeta atë në mënyrë dinake, prandaj pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarës se nuk është provuar se e akuzuara e ka kryer veprën dhe se nuk është argumentuar motivi i hakmarrjes se paskrupullt rezultojnë si të pabazuara. Njëherit kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara edhe pretendimet e mbrojtësve se gjykata pa bazë nuk e vlerësoi si provë me peshë letër-dorëshkrimin të prezantuar nga mbrojtja nga e cila vërtetohet presioni që i është bërë të akuzuarës për të pranuar veprën penale në mënyrë që të lirohet i mituri. Ani pse nga përmbajtja e këtij letër dorëshkrimi del se e akuzuara ka qene e detyruar ta pranoj veprën penale sikurse ka deklaruar në polici, edhe kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk e ka vlerësuar si provë e cila do ta shfajsonte të akuzuarën kur kihet parasysh fakti se ajo e prezantoi vetëm në shqyrtimin gjyqësor, përkundër asaj se ajo ka deklaruar disa herë radhazi në polici e pastaj në Prokurori.

Pastaj, duke i vlerësuar të gjitha provat e kësaj çështje juridiko penale, secilën veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, mbrojtjen e të akuzuarës dhe të miturit në të gjitha fazat e Procedurës, kjo Gjykatë i vlerësoi si të pabazuara pretendimet e mbrojtjes se, nuk është argumentuar se i mituri e ka ndihmuar të pandehurën në kryerjen e veprës penale. Provat materiale me theks të veçantë transkriptet e mesazheve në mes të të akuzuarës dhe të miturit, dhe vet mbrojtja e tyre tregojnë qartë se veprimet e të miturit (respektivisht kontributi i tij si ndihmës në kryerjen e kësaj veprë penale) ishin të planifikuara si para kryerjes së veprës, gjatë kryerjes dhe pas kryerjes së saj. Është përtej logjikës të pretendohet se ndihma pas kryerjes së veprës penale – mbështjellja e kufomës nuk është argumentuar, se nuk është premtuar më parë duke pas parasysh veprimet e të miturit -faktin se ai ishte vazhdimisht në shoqëri të akuzuarës. I mituri, siç ka deklaruar e akuzuara ia kishte dhënë numrin e telefonit të ndjerit, së bashku me të akuzuarën ka shkuar deri te vendtakimi i saj me të ndjerin, ka hyrë në korridorin e banesës, në tavanin e banesës – vendin e krimit, ku janë gjet gjurme të tij, janë kthyer së bashku dhe të nesërmen së bashku kanë shkuar në Prishtinë. Përveç kësaj, duke pasur parasysh mbrojtjen e të miturit të dhënë në polici përkitazi me veprën penale Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, dëshmitë e dëshmitarëve K.B., K.Sh.2, F.M. e L.S. (të cilat janë theksuar detajisht në këtë aktgjykim) po ashtu si të pabazuara kjo Gjykatë i vlerëson pretendimet e mbrojtjes se nuk është argumentuar se i mituri e ka kryer këtë vepër penale. Përveç kësaj, qëndron fakti se në dispozitiv të aktgjykimit nuk theksohet se jeta e cilëve persona është rrezikuar, por, nga kjo nuk mund të konkludohet se nuk është argumentuar se i mituri nuk e ka kryer këtë vepër penale, ngase në rastin konkret është provuar se është shkaktuar dëm thelbësor në lokalitetin e të dëmtuarit T.D. dhe dy lokale përreth.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e sipër përmendura si dhe rrethanat arsyet me të detajuara të dhëna në aktgjykimin e kundërshtuar kjo Gjykatë i vlerëson si të pabazuara pretendimet në ankesa përkitazi me shkelje të ligjit penal.

Mbrojtësit e të miturit pretendojnë se gjykata i ka tejkaluar autorizimet ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim për të mitur për faktin se ka tejkaluar

maksimumin e dënimit për burgim për të mitur, pra, aludojnë në shkelje të ligjit penal nga neni 385 par.1 nenpar.1.5 të KPP mirëpo, se a ka vepruar gjykata e shkallës së parë drejt në këtë drejtim kjo gjykatë do të jep vlerësime në vijim në kuadër të bazës ankimore sa i përket vendimit për dënim.

**c). pretendimet ankimore sa i përket vendimit për dënim.**

Prokuroria Themelore në Pejë sa i përket vendimit për dënim pretendon se dënimi i shqiptuar me burg ndaj të akuzuarës dhe ai i shqiptuar me burgim për të mitur ndaj të miturit nuk është adekuat me peshën e veprave penale. Kështu, sipas ankesës së Prokurores gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese kur gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar si të tilla sjelljen e të akuzuarës para dhe pas kryerjes së veprës ngase e akuzuara para kryerjes së veprës penale kishte planifikuar mënyrën e kryerjes së veprës penale të vrasjes, kurse pas kryerjes së veprës penale se e akuzuara ashtu edhe i mituri e kanë fsheh kufomën. Pastaj sipas Prokurores as mosha e re e të akuzuarës nuk mund të trajtohet si rrethanë lehtësuese ngase ajo në kohën e kryerjes së veprës penale kishte 27 vjet e 11 muaj e 3 ditë.

Mbrojtësit e të akuzuarës edhe pse e kundërshtojnë aktgjykimin e shkallës së parë sa i përket kësaj baze ankimore nuk e arsyetojnë këtë bazë ankimore, duke konsideruar se meqë aktgjykimi përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plote dhe është shkelur edhe ligji penal në dëm të të akuzuarës dënimi i shqiptuar me burgim nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i kundërligjshëm.

Edhe mbrojtësit e të miturit pretendojnë se dënimi me burgim i shqiptuar ndaj të miturit është jo i drejtë duke pasur parasysh se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe se ligji penal është zbatuar gabimisht. Mirëpo, pavarësisht prej kësaj pretendojnë se dënimi me burgim për të mitur është i lartë dhe jo adekuat sepse nuk janë vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese. Posaçërisht nuk është vlerësuar fakti se sipas dispozitës së nenit 65 par.2 të KPK ( i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale) parashihet se dënimi i shqiptuar nga gjykata nuk mund të jete me i lartë se tri të katërtat e maksimumit të paraparë për veprë penale dhe neni 34 par.2 i KDM me të cilin parashihet se maksimumi i dënimit me burgim për të mitur është dhjetë vjet për vepra penale të dënueshme me burgim afatgjatë dhe se për veprat penale në bashkim gjykata shqipton vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet-neni 37 par.1 i KDM. Sipas ankesës nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë ka tejkalluar maksimumin e dënimit për burgim për të mitur sepse i ka shqiptuar dënim jashtë kufijve të paraparë me ligj, ngase të miturit i ka shqiptuar dënimin me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 8 viteve, kurse për veprën e parë ( ndihmë në verën penale të vrasjes së rendë) dënimi nuk ka mund të jetë me i lartë se shtatë vjet e gjashtë muaj. Pastaj pretendohet se gjykata i ka vlerësuar gabimisht rrethanat renduese si kontributin e madh të të miturit, se tani është madhor dhe se e ka kryer edhe veprën penale të armbajtës pa leje, ngase i mituri në kohën e kryerjes së veprave ishte i mitur, dhe vepra penale e amnistuar nuk mund të merret si rrethanë renduese dhe se mbrojtja nuk e ka të qartë se në cilat fakte të vërtetuara gjykata e bazon konstatimin për kontributin shumë të madh që e ka dhënë i mituri.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë pretendimet e Prokurorit për dënime më të ashpra nuk janë të bazuara. Ndërsa, edhe pse mbrojtësit e të akuzuarës nuk e arsyetojnë

ketë bazë ankimore kjo Gjykatë vlerëson se ka vend që ndaj të akuzuarës të shqiptohet një dënim me i butë, kurse pretendimet e mbrojtësve të të miturit në këtë drejtim për tejkalim të kompetencave ligjore përkritazi me shqiptimin e dënimit me burgim për të mitur por edhe për një dënim me të butë nuk janë të bazuara.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit si rrethana lehtësuese për të akuzuarën B.H. ka vlerësuar faktin se me parë nuk ka qenë e gjykuar, moshën e saj relativisht të re, është nënë e një fëmije të mitur, ka pas sjellje tejet korrekte në gjykatë, ndërsa, si rrethanë rënduese ka vlerësuar këmbëngulësinë e saj për ta privuar nga jeta të ndjerin, motivi për të cilin është kryer vepra penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, qëllimi i të akuzuarës për fshehjen e kufomës.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë motivi i kryerjes së veprës penale në rastin konkret nuk mund të trajtohet si rrethanë rënduese sepse hakmarrja e paskrupullt si motiv i kryerjes së kësaj veprë penale është element cilësues i veprës penale, prandaj duke pasur parasysh këtë dhe të gjitha rrethanat lehtësuese të cilat i ka konstatuar dhe drejt vlerësuar gjykata e shkallës së parë përkritazi me të akuzuarën veçanërisht faktin se është nënë e një fëmije, si dhe faktin se në ankesën e Prokurores nuk ceket ndonjë rrethanë rënduese që do të ndikonte në ashpërsimin e dënimit kjo Gjykatë vlerëson se edhe me një dënim me të butë ndaj saj do të mund të arrihet qëllimi i dënimit prandaj ia shqiptoj dënimin me burg si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se ky dënim është adekuat me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarës, dhe se me të do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK.

Qëndron fakti se sipas dispozitës së nenit 65 par. 2 të KPK i cili është i aplikueshëm në rastin konkret dënimi i shqiptuar për tentativë, ndihmë dhe për bashkim kriminal nuk duhet të jete më i lartë se tre të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale, kurse sipas nenit 34 par. 2 të KDM maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë (10) vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i mituri ka kryer së paku dy (2) vepra penale në bashkim, ku secila është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë (10) vjet. Mirëpo, nga kjo nuk mund të konkludohet se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim për të mitur ka tejkaluar kompetencat ligjore ashtu siç pa bazë pretendohet në ankesë. Ngase gjykata për të dy veprat penale në bashkim ka shqiptuar dënim me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 8(tetë) viteve, pra, nuk e ka tejkaluar maksimumin e burgimit. Gjykata e shkallës së parë për të miturin ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara me dispozitën e nenit 8 par.1 të KPM lidhur me nenin dhe si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se ndaj të miturit nuk zbatohet ndonjë procedurë penale dhe as që është shqiptuar ndonjë masë edukative dhe ka pas sjellje korrekte në gjykatë, ndërsa duke pasur parasysh se në kohën e marrjes së aktgjykimit i mituri ka arrit moshën 20 vjeçare, e ka ndërprerë shkollimin, nuk punon dhe bëhet fjalë për veprën penale të dhënies së ndihmës në kryerjen e veprës penale të vrasjes së rendë, kontributin e tij para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale, mos pendimin e tij, i ka shqiptuar dënimin me burgim për të mitur në kohëzgjatje prej 8 viteve. Pra, këto rrethana gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh me rastin e matjes së dënimit dhe nuk i ka vlerësuar si rrethanë rënduese ashtu siç pretendohet në ankesën e mbrojtësve.

Prandaj, kjo Gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë drejt i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat kanë pasur ndikim në përcaktimin e saj që të miturit t'i shqiptohet dënimi me burg për të mitur, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprave të kryera penale dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra, ndërsa, meqë në

ankesën e mbrojtësve të miturit nuk ceket ndonjë rrethanë lehtësuese, kurse në atë të Prokurorit ndonjë rrethanë rënduese që do të ndikonte në shqiptimin e një dënimi me të butë apo me të ashpër kjo Gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të miturit nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjesisë penale të miturit dhe intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale, dhe se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit me burgim për të mitur.

Meqenëse aktgjykimi nën pikën III të dispozitivit të aktgjykimi përkitazi me miturin A.Ll. për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armeve-neni 328 par. 2 të KPK për të cilën është refuzuar propozimi për dënim dhe pushuar procedura penale për shkak se vepra penale është amnistuar nuk është kundërshtuar me ankesa në këtë pjesë ngel i pashqyrtuar.

Nga sa u tha me lartë e konform dispozitës se nenit 403 e 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË  
PAKR.nr.467/2014 datë 26 nëntor 2014

Procesmbajtësi,  
Shaqë Curri,

Kryetarja e kolegjit  
1. Fllanza Kadiu

Anëtarët e kolegjit:

2. Mejreme Memaj

3. Shqipe Qerimi